



Bauhaus i Ri Evropian Çmimet 2024

UDHËZUES PËR APLIKANTËT

1. Bauhaus-i i Ri Evropian

Bauhaus-i i Ri Evropian (BRE) është nismë kreative dhe ndërdisiplinore që lidh [Marrëveshjen e Gjelbër Evropiane](#) me hapësirat dhe me përvojat tona të jetesës. Kjo nismë u bën thirrje të gjithë evropianëve që të imagjinojnë dhe të ndërtojnë së bashku një të ardhme të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse që është e bukur për sytë, për mendjet dhe për shpirtrat tanë.

Duke ndërtuar ura mes prejardhjeve të ndryshme, duke përshkuar gjithë disiplinat dhe duke u mbështetur tek pjesëmarrja në të gjitha nivelet, Bauhaus-i i Ri Evropian frymëzon një lëvizje që lehtëson dhe nxit transformimin e shoqërive tona sipas tri vlerave të pandashme:

- **qëndrueshmërisë**, nga qëllimet klimatike deri te natyra qarkulluese e ekonomisë, ndotja zero dhe biodiversiteti
- **gjithëpërfshirjes**, nga vlerësimi i diversitetit e deri te sigurimi i aksesueshmërisë dhe përbalueshmërisë financiare
- **estetikës dhe cilësisë së përvojës** së njerëzve, duke i integruar ato që në fazën e projektimit dhe përfitimeve kulturore

Zgjidhjet e Bauhaus-it të Ri Evropian i mishërojnë këto vlera në veprime ku **kombinohen dimensionet lokale, evropiane dhe globale dhe përmes të cilave shfrytëzohet potenciali i qasjeve transdisiplinare dhe me pjesëmarrje të gjerë**. Përfshirja e palëve lokale të interesit në bashkëkrijimin e projekteve BRE është në qendër të kësaj nisme të Bauhaus-it të Ri Evropian.

Kjo nismë u lançua nga Komisioni Evropian në vitin 2020 dhe u bashkëprojektua me mijëra njerëz dhe organizata në të gjithë Evropën dhe më gjerë. Që atëherë, komuniteti i Bauhaus-it të Ri Evropian nuk ka reshtur së rrituri. Për ta festuar këtë arritje dhe për t'i promovuar më tej vlerat e qëndrueshmërisë, gjithëpërfshirjes dhe estetikës, në vitin 2024, **Festivali i Bauhaus-it të Ri Evropian** do të mbledhë për edicionin e dytë njerëz nga të gjitha fushat e jetës për të debatuar dhe për të formësuar të ardhmen tonë. Nën moton **'Burime për të gjithë', nga 17 prilli deri më 21 prill**, në Bruksel do të zhvillohen takime, aktivitete dhe diskutime të shumta, ndërkohë që në të njëjtën kohë, si satelitë të tyre, në qytete të ndryshme në mbarë BE-në do të ketë aktivitete të tjera paralele. Në kuadrin e këtij festivali, do të zhvillohet edhe **Ceremonia e Dhënies së Çmimeve të Bauhaus-it të Ri Evropian 2024**, ku do të festojmë projektet dhe konceptet brilante të të gjithë finalistëve dhe do të shpallim fituesit e kësaj gare.

2. Çmimet e Bauhaus-it të Ri Evropian

Çmimet e Bauhaus-it të Ri Evropian shprehin vlerësimin dhe i japin vizibilitet projekteve dhe koncepteve novatore nga qytetarë nga Evropa dhe më gjerë.

Tri edicionet e kaluara të çmimeve të Bauhaus-it të Ri Evropian në vitin 2021, 2022 dhe 2023 demonstrojnë përkushtimin e njerëzve në të gjithë Evropën dhe jashtë saj për krijimin e një bote më të qëndrueshme, më gjithëpërfshirëse dhe më të bukur. Tashmë, ky është një konkurs i konsoliduar i përvitshëm që frymëzon parimet e Bauhaus-it të Ri Evropian në projektet lokale të jetës reale. Këto çmime kanë ofruar një platformë, ku njerëzit mund të shprehin kreativitetin, talentin dhe idetë e tyre novatore në dobi të komuniteteve të tyre dhe të shoqërisë në tërësi në përputhje me qëndrueshmërinë, estetikën dhe gjithëpërfshirjen si vlera thelbësore.

Gjatë tri edicioneve të fundit, çmimet shprehën vlerësimin dhe i dhanë vizibilitet projekteve ekzistuese, si dhe koncepteve të zhvilluara nga talente të reja dhe premtuese. Me më shumë se 4,500 aplikime të marra gjithsej dhe 52 fituesve, këto çmime janë dëshmi e një përkushtimi të jashtëzakonshëm të individëve dhe organizatave ndaj nismës së Bauhaus-it të Ri Evropian.

3. Edicioni i Çmimeve të vitit 2024 të Bauhaus-it të Ri Evropian

Megjithëse elementët kryesorë të çmimeve të Bauhaus-it të Ri Evropian mbeten të pandryshuara, edicioni i katërt vjen me tri risi:

Së pari, edicioni i vitit 2024 i Çmimeve do t'i kushtojë një vëmendje të veçantë rajoneve që përballen me disa nga çështjet më të ngutshme social-ekonomike në BE dhe që janë në thelb të masave të politikës së kohezionit të BE-së. Këto janë rajone që përballen me sfidat më intensive, si me sigurimin e standardeve të mira të jetesës për qytetarët, sigurimin e aksesit universal në shërbimet bazë, adresimin e papunësisë dhe mbajtjen e talenteve të reja. Përveç kësaj, Çmimet e vitit 2024 do të fokusohen në vendet që janë prekur më shumë nga kostot social-ekonomike që rrjedhin nga ndryshimet klimatike, duke u mëshuar veçanërisht rajoneve të mbështetura nga 'Fondi i Tranzicionit të Drejtë' - një pjesë e pandashme e përpjekjeve të BE-së për t'i ndihmuar këto territore në diversifikimin dhe rishndërrimin e tyre.

Me qëllim nxitjen e ndryshimeve pozitive në këto territore, veçanërisht duke ofruar shembuj frymëzues për adresimin me sukses të problemeve me të cilat ato përballen, **një e katërta e çmimeve do t'u jepet aplikimeve të projekteve dhe koncepteve me origjinë nga këto rajone**. Hartat e rajoneve që do të merren në konsideratë gjenden në Shtojcën 1, së bashku me një listë të këtyre rajoneve në Shtojcën 2¹.

E dyta, edicioni i vitit 2024 i Çmimeve, përveç shteteve anëtare të BE-së dhe Ballkanit Perëndimor, do të mirëpresë **aplikimet e projekteve dhe koncepteve në Ukrainë**.

E treta, për të njohur dhe për të mbështetur **përpjekjet për rezistencë, rimëkëmbje dhe rindërtim të Ukrainës**, pjesë e Çmimeve të vitit 2024 do të jetë edhe një çmim i dedikuar një projekti ose një koncepti që mbështet përpjekjet për rindërtimin dhe rimëkëmbjen e këtij vendi në frymën e Bauhaus-it të Ri Evropian. Çmimi "**Vlerësim i**

¹ Siç përcaktohet në Rregulloren (BE) 2021/1060 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 24 qershorit 2021 që përcakton dispozita të përbashkëta për Fondin Evropian të Zhvillimit Rajonal, Fondin Social Evropian Plus, Fondin e Kohezionit, Fondin e Tranzicionit të Drejtë dhe Fondin Evropian të Detit, Peshkimit dhe Akuakulturës dhe rregullat financiare për ata dhe për Fondin për Azilin, Migracionin dhe Integrimin, Fondin e Sigurisë së Brendshme dhe Instrumentin për Mbështetjen Financiare për Menaxhimin e Kufirit dhe Politikën dhe Rregulloren për Viza (BE) 2021/1056 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 24 qershorit 2021 për krijimin e Fondit të Tranzicionit të Drejtë.

veçantë për përpjekjet për rindërtimin dhe rimëkëmbjen e Ukrainës" synon të njohë dhe të kontribuojë në përgatitjen e rindërtimit të Ukrainës, si dhe në përpjekjet e tjera për rimëkëmbjen sociale dhe ekonomike të vendit. Ai inkurajon projekte dhe koncepte të përafuara me vlerat dhe parimet e Bauhaus-it të Ri Evropian që ndikojnë pozitivisht në aspektet infrastrukturore, sociale, ekonomike (ose në një kombinim të këtyre aspekteve) të procesit të rimëkëmbjes në Ukrainë dhe do ta vlerësojë projektin ose konceptin më të mirë mes tyre me një çmim të dedikuar. Ky vlerësim i veçantë duhet të ofrojë frymëzim dhe të nxisë rritjen e bashkëpunimit dhe angazhimit midis partnerëve ukrainas dhe komunitetit BRE.

Ashtu si në dy edicionet e fundit, Çmimet e vitit 2024 do të jepen për katër kategori të krijuara, të cilat bazohen në boshtet tematike të transformimit që drejtojnë ofrimin e Bauhaus-it të Ri Evropian²:

- **Rilidhja me natyrën**
- **Rikthimi i ndjenjës së përkatësisë**
- **Prioritizimi i vendeve dhe njerëzve që kanë më shumë nevojë**
- **Formësimi i një ekosistemi industrial qarkullues dhe mbështetja e të menduarit gjatë gjithë ciklit të jetës**

Në secilën nga këto katër kategori, janë krijuar dy fusha paralele konkurrence:

- **Kapitulli A: "Kampionët e Bauhaus-it të Ri Evropian"** do t'i kushtohet projekteve ekzistuese dhe të përfunduara me rezultate të qarta dhe pozitive.
- **Kapitulli B: "Yjet në Ngritje të Bauhaus-it të Ri Evropian"** do t'i kushtohet koncepteve të paraqitura nga talente të reja të moshës 30 vjeç ose më të rinj. Këto koncepte mund të jenë në faza të ndryshme të zhvillimit të tyre, që nga idetë me plane të qarta deri tek prototipet.

Në kuadër të Çmimeve të vitit 2024 do të jepen gjithsej **20 çmime**:

- Në Kapitullin A, në secilën kategori, një juri ekspertësh do të përzgjedhë 1 kampion dhe 1 nënkampion (d.m.th., 4 kampionë dhe 4 nënkampionë)
- Në Kapitullin B, në secilën kategori, një juri ekspertësh do të përzgjedhë 1 kampion dhe 1 nënkampion (d.m.th., 4 vende të para dhe 4 vende të dyta)
- Në të gjitha kategoritë dhe në të gjithë kapitujt, një juri ekspertësh do të përzgjedhë 1 kampion dhe 1 nënkampion nga Ukraina për çmimin "Vlerësim i veçantë për përpjekjet për rindërtimin dhe rimëkëmbjen e Ukrainës"
- Në secilin Kapitull, do të zgjidhet 1 fitues për të gjitha kategoritë nga një votim online i publikut (d.m.th. 2 fitues gjithsej)

Një e katërta e të gjitha çmimeve (d.m.th. të paktën 5 çmime gjithsej në të gjitha kategoritë dhe kapitujt) do t'u ndahet aplikimeve që ndodhen në ato rajone të BE-së që përballen me sfidat më intensive socio-ekonomike dhe në vendet që sfidohen më së shumti nga nevoja e evoluimit drejt një ekonomi neutrale ndaj karbonit. (Shih hartat e

² Kategoritë shprehin vizionin e zhvilluar në [Komunikimin](#) e Komisionit Evropian mbi Bauhaus-in e Ri Evropian, duke u mbështetur nga kontributet e palëve të interesit në fazën e projektimit nga poshtë – lart të nismës.

rajoneve të pranueshme në Shtojcën 1, së bashku me listën e këtyre rajoneve në Shtojcën 2).

Të gjithë fituesit do të shpallen në një ceremoni zyrtare të organizuar nga Komisioni Evropian, në Festivalin e Bauhaus-it të Ri Evropian.

4. Çmimet

Kampionët dhe nënkampionët do të marrin një çmim monetar:

- **30,000 Euro** për Kampionët e Bauhaus-it të Ri Evropian (Kapitulli A)
- **15,000 Euro** për Kampionët e Yjeve në Ngritje të Bauhaus-it të Ri Evropian (Kapitulli B)
- **20,000 Euro** për Nënkampionët e Bauhaus-it të Ri Evropian (Kapitulli A)
- **10,000 Euro** për Nënkampionët e Yjeve në Ngritje të Bauhaus-it të Ri Evropian (Kapitulli B)
- **30,000 Euro** për Kampionin e çmimit "Njohje e veçantë për përpjekjet për rindërtim dhe rimëkëmbje të Ukrainës".
- **15,000 Euro** për Nënkampionin e çmimit "Njohje e veçantë për përpjekjet për rindërtim dhe rimëkëmbje të Ukrainës".

Përveç shumës monetare, çdo kampion dhe nënkampion do të përfitojë dhe një paketë komunikimi të ofruar nga Komisioni Evropian (p.sh. promovimi në mediat sociale dhe në faqet e internetit të Komisionit Evropian, prodhimin e një videoje të shkurtër dhe mbështetje në promovimin e projekteve).

5. Katër kategoritë



Rilidhja me natyrën

Ne do të jemi të interesuar të shohim shembuj frymëzues projektsh të bukura, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse që i afrojnë individët dhe komunitetet me natyrën, që kontribuojnë në rigjenerimin e ekosistemeve natyrore dhe në moshumbjen e biodiversitetit ose që i ftojnë ata që ta rikonsiderojnë marrëdhënien e tyre me natyrën nga një perspektivë me në qendër jetën, si një alternativë ndaj perspektivës me në qendër njeriun.

Shembuj të tillë mund të jenë transformimi fizik i vendeve që tregojnë se si mjediset e reja, të rinovuara ose të rigjeneruara dhe hapësirat publike mund të **kontribuojnë në mbrojtjen, restaurimin dhe/ose rigjenerimin e ekosistemeve natyrore** (duke përfshirë edhe ciklet e tokës dhe të ujit) dhe tek **biodiversiteti**. Përdorimi i **zgjidhjeve dhe materialeve me bazë natyrën** mund të jetë një dimension i rëndësishëm i transformimit fizik.

Transformimi duhet të favorizojë edhe përfshirjen shoqërore, si për shembull duke marrë gjithmonë në konsideratë se sa të përbalueshme ekonomikisht dhe sa të aksesueshme janë vende të caktuara, duke përfshirë parimet e të projektuarit në të mirë të të gjithëve, duke përdorur **ruajtjen dhe restaurimin e mjedisit**, si një detyrë e përbashkët për të gjithë komunitetin dhe duke i përdorur **zonat e gjelbra si ura lidhëse** mes hapësirave të përbashkëta të

rretheve të ndryshme. Transformimi duhet të sjellë përfitime sa i përket cilësisë së përvojës së komuniteteve, si për shembull duke marrë parasysh traditat dhe trashëgiminë kulturore lokale dhe nevojat përkatëse.

Këta shembuj mund të tregojnë edhe se si ngjarjet, aktivitetet, proceset, produktet mund të **përcjellin ndjesi ose përvojën e të qenit pjesë e natyrës dhe të sjellin një ndryshim të këndvështrimit ndaj natyrës**. Këto mund të jenë iniciativa në bazë lagjesh, iniciativa në terren, initiative artistike, festivale, etj.

2



Rikthimi i ndjenjës së përkatësisë

Ne do të shohim shembuj frymëzues projektsh të bukura, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse që kontribuojnë për të sjellë ndjesinë e përkatësisë, që u japin "frymë" ose "kuptim" vendeve, komuniteteve ose produkteve dhe që përkrahin diversitetin.

Shembuj të tillë mund të jenë transformimi fizik i vendeve që tregojnë se si mjediset e reja, të ripërtëritura, të rinovuara ose të rigjeneruara mund të **lidhen me trashëgiminë dhe traditat historike lokale apo me veçori lokale të realiteteve bashkëkohore demografike, dinamikave dhe stileve të jetesës kulturore dhe artistike**. Ato gjithashtu mund të ilustrojnë se si proceset rigjeneruese mund të kontribuojnë në **rikthimin e ndjenjës së përkatësisë ose në formësimin e ambicieve të orientuara drejt së ardhmes për komunitetet në nivel lokal ose rajonal**. Ripërdorimi i hapësirave për **shkëmbime pozitive midis brezave dhe për forcimin e komuniteteve** mund të jenë dimensione të rëndësishme.

Shembujt të tjerë mund të përfshijnë edhe zhvillimin e produkteve, proceseve ose modeleve të biznesit që **bazohen te kultura, traditat, njohuritë, artizanati dhe diversiteti dhe krijimtaria bashkëkohore lokale**. Mund të jetë moda, orënditë ose dizajni i brendshëm, por edhe ushqimi ose elementë të tjerë të jetës sonë të përditshme që mbartin një ndjenjë përkatësie në nivel lokal.

3



Prioritizimi i vendeve dhe njerëzve që kanë më shumë nevojë

Do të duhet të shohim shembuj frymëzues projektsh të bukura, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse që kontribuojnë në adresimin e nevojave të territoreve, komuniteteve dhe individëve që kanë nevojë për vëmendje të veçantë dhe urgjente për shkak të karakteristikave të tyre specifike ekonomike, sociale ose fizike.

Shembujt të tillë mund të jenë transformimi fizik dhe rigjenerimi i territoreve dhe vendeve, duke përfshirë fshatrat e vegjël, zonat rurale, qytetet në tkurrje, zonat e rrënuara të qyteteve, zonat e çindustrializuara, vendet që mirëpresin refugjatët ose vendet që aspirojnë të jenë të aksesueshme për të gjithë. Këtu mund të përfshihet zhvillimi i **projekteve ambicioze të strehimit social dhe të përkohshëm dhe rikonvertimi, rinovimi, rigjenerimi i ndërtesave dhe rrethinave të tyre për të luftuar segregimin dhe izolimin**. Shembujt të tjerë mund të jenë edhe adresimi i nevojave të

veçanta të grupeve dhe individëve që janë më të prekurit, për shembull, **të larguarit nga konfliktet e armatosura, të rrezikuarit nga varfëria, ose të pastrehët.**

Shembuj mund të ilustrojnë gjithashtu edhe se si zbatimi i avancuar i parimit "**projektim për të gjithë**" në transformimin e mjediseve të të ndërtuara nga njeriu mund të adresojë çështjet e aksesit për personat me aftësi të kufizuara, si dhe të adresojë problematikat e të moshuarve.

Propozime të tjera mund të tregojnë se si **shërbimet komunitare**, mënyrat e reja të bashkimit të komuniteteve të ndryshme (p.sh. mjediset me shumë breza) dhe/ose funksionet e ndryshme (strehimi, përfshirja sociale, etj.) së bashku, mund të sjellin **zgjdhje të reja për të adresuar nevojat e veçanta**. Shembuj mund të përfshijnë edhe modele pronësie dhe biznesi si **skemat kundër spekulimeve, modelet e bashkëpunimit ose investimet me ndikim.**



Formimi i një ekosistemi industrial qarkullues dhe mbështetja e të menduarit për ciklin jetësor

Do të shohim shembuj frymëzues projektesh të bukura, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse që kontribuojnë në transformimin e ekosistemeve industriale drejt praktikave më të qëndrueshme në frymën e qarkullimit, duke marrë parasysh aspektet e përshtatshme shoqërore.

Shembuj mund të përfshijnë transformimin e elementeve të zinxhirëve të vlerave specifike nga marrja e lëndëve të para deri në riciklimin e mbetjeve në ekosisteme të ndryshme, nga **ndërtimi në sektorët e tekstilit dhe stilit të jetesës** (orendi, dizajn, etj.). Në këtë kuptim, shembuj mund të jenë proceset dhe materialet e reja, **zgjdhjet dhe produktet natyrale me burim të qëndrueshëm**, ose modele të reja biznesi, që sjellin përfitime të qarta në aspektin e qëndrueshmërisë dhe qarkullimit, si dhe në aspektin e cilësisë së jetës dhe dizajnit për të gjithë. Sipas rastit, duhet të integrohen edhe aspektet e përbalueshmërisë dhe të përfshirjes shoqërore.

Shembuj mund të promovojnë modele të reja ekonomike, në veçanti në **ekonominë sociale dhe të zonës dhe të ndikojnë në investime**. Shembuj mund të përfshijnë iniciativa, të cilat nëpërmjet transformimit të ekosistemit apo proceseve industriale kanë kontribuar edhe në zhvillimin e përgjithshëm socio-ekonomik të zonës/rajonit. Shembuj mund të përbëhen nga metoda, mjete ose udhëzime, të cilat lehtësojnë (vetë)vlerësimin e performancës së qarkullimit për lloje të ndryshme mallrash dhe shërbimesh.

6. Si aplikohet

Aplikimet për Çmimet e Bauhaus-it të Ri Evropian duhet të dorëzohen përmes platformës së dedikuar. Projektet e përfunduara (Kapitulli A) ose konceptet (Kapitulli B) duhet të përshkruhen në detaje në formularin përkatës të aplikimit.

Në aplikim duhet të shpjegohet me detaje se si i reflekton dhe si i përkthen projekti ose koncepti përkatës **vlerat dhe parimet e punës të Bauhaus-it të Ri Evropian**. Ai gjithashtu duhet të përfshijë elemente që pasqyrojnë **kriteret e përshtatshmërisë dhe të vlerësimit**, të cilat janë të ndryshme për secilën pjesë (shih më poshtë).

Një aplikim mund të dorëzohet për konkurrim vetëm për një kategori dhe vetëm për një kapitull. Çdo aplikant mund të paraqesë disa aplikime, për sa kohë ato lidhen me projekte ose me koncepte të ndryshme.

Aplikantët për çmimin "Vlerësim i veçantë për përpjekjet për rindërtim dhe rimëkëmbje të Ukrainës" **duhet të shënojnë në formularin e aplikimit se janë të interesuar për të aplikuar për këtë çmim.** Të drejtën për të konkurruar për këtë çmim e kanë vetëm aplikantët nga Ukraina dhe projektet ose konceptet duhet të zbatohen në Ukrainë.

Periudha e aplikimit fillon më **02 tetor 2023** dhe përfundon më **10 nëntor 2023 në orën 19:00³.**

Jeni të ftuar ta ndiqni platformën e çmimeve të Bauhaus-it të Ri Evropian për më shumë informacion dhe përditësime të mëtejshme, ndërkohë që pyetjet që keni mund t-i dërgoni në kutinë postare funksionale (EC-Contact-NEB-Prizes@ec.europa.eu) të shënuar në platformë.

Aplikimet mund të ndryshohen dhe të përditësohen për sa kohë janë në gjendje drafti. Ju lutemi, mos prisni deri në ditën e fundit të afatit për ta dorëzuar aplikimin tuaj për të shmangur probleme që mund të dalin në moment të fundit, si vonesat në ngarkimin e faqeve që mund të ndodhin në lidhje me dorëzimin e aplikimeve. Komisioni i Vlerësimit do të shqyrtojë vetëm aplikimet që dorëzohen brenda afatit zyrtar.

7. Kriteret e pranimit

Në seksionin në vijim ofrohen shpjegime të hollësishme mbi kriteret që duhet të plotësohen nga aplikantët dhe nga aplikimet. Për t'ju ndihmuar që të verifikoni nëse i plotësoni apo jo kriteret e pranimit, keni një tabelë në Shtojën 3.

7.1. Aplikantët që pranohen të marrin pjesë

Të gjithë **aplikantët** për Çmimet e Bauhaus-it të Ri Evropian duhet të plotësojnë këto kriteret:

1. Aplikantët mund të jenë ose jo banorë të BE-së, për sa kohë projektet dhe konceptet e tyre zbatohen në BE ose në Ballkanin Perëndimor⁴, ose në Ukrainë.
2. Për çmimin "Vlerësim i veçantë për përpjekjet për rindërtim dhe rimëkëmbje të Ukrainës", ju lutemi shikoni specifikimet në pikën 7.2. "Qartësim për çmimin 'Vlerësim i veçantë për përpjekjet për rindërtim dhe rimëkëmbje të Ukrainës'

³ Gjatë periudhës së aplikimeve, Komisioni Evropian mund të nxjerrë një vendim për të zgatur afatin e aplikimit. Një vendim për zgjatjen e afatit komunikohet në faqen e internetit të Çmimeve NEB të vitit 2024.

⁴ Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova*, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi dhe Serbia.

* Ky përcaktim është pa paragjykuar pozicionet rreth statusit, dhe është në përputhje me Rezolutën 1244/1999 të KS të OKB-së dhe opinionin e GJND-së mbi deklaratën e pavarësisë së Kosovës.

3. Për disa subjekte zbatohen disa rregulla të veçanta (p.sh. për subjektet që i nënshtrohen masave kufizuese të BE-së, sipas nenit 29 të Traktatit për Bashkimin Evropian (TEU) dhe nenit 215 të Traktatit për Funkcionimin e BE-së (TFEU)⁵ dhe subjektet e përfshira në Udhëzimet e Komisionit Nr. 2013/C 205/05⁶). Këto subjekte nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në asnjë lloj cilësie.
4. Aplikimi duhet të dorëzohet nga:
 - a) Në kapitullin A: nga individ(ët) ose organizatat, (qyteti ose rajoni, financuesi, organizatori) që ka(në) të drejtën e përfaqësimit të projektit.
 - b) Në kapitullin B: nga individ(ët) ose organizatë(at), që janë autor(ë) të konceptit. Nëse prapa konceptit janë disa bashkëautorë që kanë marrë pjesë në hartimin/zhvillimin e tij, duhet të renditen në një listë të gjithë autorët, sipas rastit. Të gjithë aplikantët në këtë kapitull duhet të jenë 30 vjeç ose më të rinj në ditën e fundit të thirrjes për aplikime, duke përfshirë edhe të gjithë përfaqësuesit e organizatës së përfshirë në krijimin e konceptit të dhënë.
5. Aplikanti nuk duhet të ndodhet në një ose në më shumë se një nga situatat e përjashtimit të parashikuara në Nenin 136 të Rregullores Financiare⁷.
6. I vetmi që do të mbajë përgjegjësinë në rast të çfarëdolloj pretendimi në lidhje me aktivitetet e kryera në kuadër të këtij konkursi është aplikanti.
7. Duhet të bëhet i ditur emri i përfaqësuesit juridik.

7.2. Aplikimet e pranueshme

Përveç kësaj, të gjitha **aplikimet** për çmimin e Bauhaus-it të Ri Evropian duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

1. Aplikimi duhet të dorëzohet nëpërmjet platformës online jo më vonë se data 10 nëntor 2023, ora 19:00.
2. Aplikimet duhet të dorëzohen në gjuhën angleze.
3. Duke qenë se financimi i dyfishtë është rreptësisht i ndaluar, aplikimet që mbulojnë projekte ose koncepte, të cilat tashmë kanë marrë një çmim monetar të financuar nga BE-ja, nuk mund të marrin pjesë në konkurs.
4. Aplikimet për projekte ose për koncepte që kanë marrë tashmë fonde publike, duke përfshirë edhe nga BE-ja, (p.sh. një grant) janë të pranueshme, për sa kohë nuk kanë fituar një çmim monetar të BE-së.
5. Aplikimet e pranueshme, të cilave nuk u është dhënë çmim i Bauhaus-it të Ri Evropian në asnjërin nga kapitujt dhe kategoritë në edicionet e mëparshme të çmimit të Bauhaus-it të Ri Evropian mund të paraqesin përsëri aplikime për të njëjtin projekt ose koncept, me kusht që të marrin parasysh kriteret e pranimit siç përshkruhen në këtë Udhëzues për Aplikantët.
6. Nuk mund të paraqitet i njëjti projekt ose koncept për kategori ose për kapitull të ndryshëm.

⁵ Vini re, Gazeta Zyrtare e BE-së përmban listën zyrtare dhe, në rast konflikti, përmbajtja e saj qëndron mbi [Hartën e Sanksioneve të BE](#)

⁶ Udhëzimet e Komisionit Nr. [2013/C 205/05](#) mbi pranueshmërinë e subjekteve izraelite dhe aktivitetet e tyre në territoret e pushtuara nga Izraeli që nga qershori 1967 për grante, çmime dhe instrumente financiare të financuara nga BE-ja nga viti 2014 e tutje (OJEU C 205 e 19.07.2013, f. 9-11).

⁷ Neni 136, <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/HTML/?uri=CELEX:32018R1046&from=en>

7. I(të) njëjti(ët) aplikant(ë) mund të paraqesë(in) më shumë se një aplikim, por këto duhet të jenë aplikime (projekte ose koncepte) të ndryshme për kategori ose kapituj të ndryshëm, shih pikën 6 më sipër. Nuk lejohet të paraqitet i njëjti aplikim dy herë. Aplikimet e shumta që lidhen me të njëjtin projekt ose koncept sipas kategorive ose kapitujve të ndryshëm nuk pranohen.
8. Aplikimi duhet të përbëhet nga formulari i aplikimi i plotësuar plotësisht, siç gjendet në faqen e internetit; të gjitha fushat e detyrueshme duhet të plotësohen siç duhet. Çdo aplikant duhet të nënshkruajë Deklaratën e Privatësisë që shoqëron formularin e aplikimit.
9. Aplikimi duhet të përmbajë informacionin bazë dhe kreditet për veprën/konceptin, së bashku me:
 - Në kapitullin A: të paktën gjashtë fotografi me tregues mbi të drejtën e autorit dhe autorizimin për t'i përdorur ato nga Komisioni Evropian. Për projektet që nuk mund të paraqiten përmes fotografive, mund të përdoren lloje të tjera të paraqitjes vizuale (grafikë, vizatime, etj.).
 - Në kapitullin B: të paktën një fotografi ose paraqitje vizuale e konceptit me tregues mbi të drejtën e autorit dhe autorizimin për përdorimin e tyre nga Komisioni Evropian.
10. Aplikantët duhet t'i referohen qartë kategorisë së çmimit dhe kapitullit për të cilin aplikojnë në formularin e tyre të aplikimit.
11. Të gjitha aplikimet duhet të lidhen me një vendndodhje/rajon konkret, të kenë një grup të synuar qartë dhe objektiva të përcaktuara qartë. Ato duhet të reflektojnë se si kontribuojnë në trajtimin e sfidave specifike me të cilat përballet zona e vendndodhjes/rajonit të tyre.
12. Aplikimet duhet të shpjegojnë se si projekti ose koncepti integron dhe promovon vlerat dhe parimet e punës së Bauhaus-it të Ri Evropian dhe se si ato do të përmirësojnë jetën e njerëzve dhe komuniteteve në një afat më të gjatë.
13. Projektet dhe konceptet duhet të zbatohen në BE, në Ballkanin Perëndimor ose në Ukrainë.
14. Projektet dhe konceptet që tregojnë një shtrirje gjeografike ndërkombëtare në formularin e aplikimit duhet të zbatohen kryesisht në BE, në Ballkanin Perëndimor ose në Ukrainë.
15. Në të gjithë kapitujt, projektet dhe konceptet që nuk janë të zbatueshme në kontekste të ndryshme, nuk janë të pranueshme. Me “zbatueshmëri” nënkuptohet mundësia e zbatimit të projektit në lokalitete të ndryshme nga ai nga vjen.
16. Aplikimet duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme në lidhje me maturimin (ecurinë e zbatimit), të cilat duhet të dëshmojnë me dokumente bashkëngjitur formularit të aplikimit:
 - a) Projektet në kapitullin A duhet të jenë të përfunduar plotësisht në momentin e aplikimit. I përfunduar plotësisht do të thotë se nuk ka asnjë komponent që mungon në projekt (qofshin komponentë fizike/materialë apo jomaterialë). Proceset, mjetet, modelet e biznesit, metodat etj. duhet të jenë zhvilluar plotësisht deri në momentin e aplikimit. Projektet në këtë kapitull duhet të jenë zbatuar ose aplikuar në të paktën një rast specifik.

- b) Konceptet në kapitullin B mund të jenë në faza të ndryshme zhvillimi, nga konceptet në fazat e hershme deri në nivel prototipi dhe duhet të paraqiten me një plan zhvillimi, duke përshkruar hapat e parashikuar e të parashtruar për zhvillimin e mëtejshëm, promovimin dhe/ose për zbatimin e konceptit me një vëmendje të veçantë për vitin pas aplikimit.
17. Aplikimi duhet të përfshijë dëshmi të nivelit të maturimit, rezultateve, ecurisë së zbatimit dhe këto janë të ndryshme për secilin nga kapitujt, shoqëruar me dokumentet e duhura bashkangjitur aplikimit si vijon:
- a) Për kapitullin A, aplikimi duhet të detajojë rezultatet e arritura dhe përfundimet e projekteve të realizuara, p.sh. raporti i vlerësimit, raporti përfundimtar i projektit, certifikimi përkatës etj.
- b) Për kapitullin B, aplikimi duhet të demonstrojë përkushtimin për implementim të konceptit në praktikë, duke përfshirë një plan zhvillimi, duke detajuar hapat e parashikuar për zhvillimin dhe për zbatimin e mëtejshëm të konceptit.
18. Aplikimet që tregojnë një shtrirje gjeografike ndërkombëtare duhet të demonstrojnë qartë dhe të ofrojnë dëshmi për një partneritet ose bashkëpunim, me një ose më shumë shtete anëtare të BE-së, Ballkanin Perëndimor dhe/ose Ukrainën. Ky partneritet apo bashkëpunim nuk ka nevojë të jetë marrëveshje e formalizuar, por duhet të konsiderohet si vërtetë e përbashkët dhe bashkëpunuese. Aplikimi duhet të tregojë se si partnerët përtej kufijve bashkëpunojnë në dy dimensionet e mëposhtme: zhvillimi dhe zbatimi i përbashkët (p.sh., se si projekti ose koncepti është bashkë-projektuar me partnerët ndërkombëtarë, të shpjegojë rolin e secilit partner në faza të ndryshme në secilin vend ku projekti ose koncepti zbatohet). Aplikimet që nuk kanë prova për një shtrirje gjeografike ndërkombëtare do të konsiderohen si projekte/koncepte kombëtare, të lidhura me kombësinë e aplikantit.

Qartësim për çmimin 'Vlerësim i veçantë për përpjekjet për rindërtim dhe rimëkëmbje të Ukrainës

Inkurajojmë **aplikantët** nga Ukraina për t'u bashkuar me Komunitetin BRE dhe për të reflektuar mbi rolin e BRE si një kornizë udhëzuese, në përputhje me politikat e BE-së, duke lidhur në mënyrë efektive fushat e qëndrueshmërisë, përfshirjes sociale dhe sfidave kulturore.

Duke i zgjeruar Çmimet e vitit 2024 me përfshirjen edhe të aplikimeve nga Ukraina, ne njohim qëndrueshmërinë e popullit ukrainas përballë vështirësive, si dhe krijimtarinë dhe talentin e tyre të shoqëruar me përkushtimin për rimëkëmbje dhe rindërtim në përputhje me vlerat e Bauhaus-it të Ri Evropian.

Me këtë çmim special që vlerëson projektin ose konceptin më të mirë mes aplikimeve nga Ukraina, ne synojmë të shpërblejmë zgjidhje të jashtëzakonshme që mund të ofrojnë frymëzim për të mbështetur përgatitjen e rindërtimit dhe rimëkëmbjes në Ukrainë me parim 'rindërto-më-mirë', që përfshin një ndjenjë identiteti dhe përkatësie të rrënjosur në kulturën lokale në përputhje me parimet e qëndrueshmërisë, estetikës dhe gjithëpërfshirjes.

Si aplikohet?

Aplikantët e interesuar për të aplikuar për çmimin "Vlerësim i veçantë për përpjekjet për rindërtim dhe rimëkëmbje të Ukrainës" duhet ta bëjnë të qartë se janë të interesuar për këtë çmim të veçantë në plotësimin e formularit të aplikimit. Aplikimi duhet të plotësojë edhe kriteret e pranimit për të konkurruar në konkursin kryesor të Çmimeve sipas kategorisë dhe kapitullit, ku e paraqet aplikanti aplikimin dhe, përveç kësaj, të konsiderohet edhe për vlerësimin e veçantë. Sidoqoftë, çdo projekt ose koncept mund të fitojë vetëm një çmim, ose çmim në konkursin e zakonshëm ose si çmimin "Vlerësim i veçantë për përpjekjet për rindërtim dhe rimëkëmbje të Ukrainës".

Kriteret e pranimit:

Përveç plotësimit të kriterëve të pranimit të përshkruara më sipër, aplikimi dhe aplikantët duhet të plotësojnë këto kriterë:

19. Të drejtën e aplikimit e kanë vetëm aplikantët nga Ukraina (individë dhe organizata) dhe projektet ose konceptet që zbatohen në Ukrainë.
20. Individët që aplikojnë për Vlerësimin e veçantë për përpjekjet për rindërtim dhe rimëkëmbje të Ukrainës' duhet të kenë shtetësi ukrainase ose të jenë banorë të Ukrainës. Të drejtë aplikimi kanë edhe personat e zhvendosur përkohësisht në vende të tjera, por që kanë banuar në Ukrainë përpara agresionit të Ruisë.
21. Organizatat që aplikojnë për çmimin 'Vlerësim i veçantë për përpjekjet për rindërtim dhe rimëkëmbje të Ukrainës' duhet të jenë me vendndodhje në Ukrainë. Organizatat, aktivitetet dhe veprimet thelbësore të cilave po koordinohen aktualisht nga jashtë territorit ukrainas për shkak të agresionit të Ruisë janë të pranueshme, me kusht që aktivitetet dhe veprimet thelbësore të zbatohen në Ukrainë ose do të zbatohen në Ukrainë në rrethana normale.
22. Aplikimet me një shtrirje gjeografike ndërkombëtare që përfshijnë një ose më shumë shtete anëtare të BE-së, ose/dhe Ballkanin Perëndimor, përveç Ukrainës, janë të pranueshme. Megjithatë, projekti ose koncepti duhet të jetë kryesisht i vendosur në Ukrainë.
23. Aplikimi duhet të pasqyrojë se si projekti mbështet përpjekjet e rindërtimit dhe rimëkëmbjes në Ukrainë dhe duhet t'i referohet qartë kategorisë së çmimit për të cilin merr pjesë.

8. Kriteret e vlerësimit

Renditja dhe përzgjedhja përfundimtare e fituesve do të konfirmohet nga Komisioni i Vlerësimit, i përbërë nga anëtarë të Komisionit Evropian që kanë përgjegjësinë e plotë për zhvillimin si duhet dhe për rezultatin e konkursit.

Vlerësimi i cilësisë së aplikimeve do të kryhet nga ekspertë të jashtëm, të pavarur, në bazë të kriterëve të mëposhtme të dhënies së çmimit. Për cilësinë e propozimit do të jepen maksimumi 100 pikë. Për secilin kriter, kërkohet një rezultat minimal prej 50%. Në listën e finalistëve mund të përfshihen vetëm propozimet që plotësojnë këtë prag.

8.1. Kriteret e dhënies së çmimit për të gjithë kapitujt (A dhe B):

- a) Karakteri dallues shembullor për sa i përket tri **vlerave thelbësore** të Bauhaus-it të Ri Evropian (**40 / 100 pikë**):
1. **Qëndrueshmëria:** në kuptimin mjedisor, për shembull, zvogëlimi i ndikimit mjedisor të aktiviteteve njerëzore, avancimi i çarkullimit dhe eko-dizajnit, zbatimi i zgjidhjeve të bazuara në natyrë, parandalimi i humbjes së biodiversitetit, promovimi i aktiviteteve ekonomike që përfshijnë mënyrat e ruajtjes, të menduarit dhe rigjenerimin e ciklit jetësor. Qëndrueshmëria sociale nuk futet në këtë dimension, as mirëmbajtja e projektit dhe financat e qëndrueshme pas projektit – qëndrueshmëria ‘financiare’.
 2. **Gjithëpërfshirja:** në dimensione të ndryshme, duke filluar nga aksesimi dhe përbalueshmëria për të gjithë në sistemet qeverisëse gjithëpërfshirëse, modelimi për të gjitha parimet ose modelet e reja shoqërore. Kjo përfshin vlerësimin e diversitetit, promovimin e shkëmbimeve mes brezave, adresimin e ndarjes dhe izolimit hapësinor, mbështetjen e anëtarëve të cenueshëm të komunitetit dhe rritjen e mundësive për ndërveprim social mes të gjithëve.
 3. **Estetika dhe cilësia e përvojës për njerëzit:** përmes modelimit dhe përfitimeve emocionale/kulturore, për shembull lidhja me cilësitë e një vendi, nxitja e ndjenjës së përkatësisë përmes përvojave kuptimplota ose integrimi i vlerave të reja të qëndrueshme kulturore dhe sociale.
- b) Karakteri dallues sa u përket tre **parimeve kryesore të punës** të Bauhaus-it të Ri Evropian (**35 / 100 pikë**):
1. **Procesi i pjesëmarrjes:** përfshirja e komuniteteve të prekura nga projekti në fazën e bashkë-projektimit, vendimmarrjes dhe zbatimit, fuqizimi i komuniteteve lokale.
 2. **Angazhimi me shumë nivele:** shkëmbim efektiv si horizontalisht – me kolegët – ashtu edhe vertikalisht – me të tjerët që veprojnë në shkallë të ndryshme; për të lidhur palët e interesit të niveleve të ndryshme që kanë qëllime të përbashkëta.
 3. **Qasja transdisiplinare:** angazhim i profesionistëve dhe njohurive nga fusha të ndryshme si dhe mbështetja tek njohuritë e joakademikëve dhe të publikut.
- c) **Dimensioni novator** në krahasim me praktikat kryesore. (**10 / 100 pikë**)
- d) Potencial i lartë për **transferueshmëri dhe realizueshmëri** (p.sh. të metodologjisë, zgjidhjeve dhe përvojave) në kontekste të ndryshme. (**5 / 100 pikë**).

8.2. Kriteret specifike të akordimit të çmimit sipas kapitujve:

Për kapitullin A - Kampionët e Bauhaus-it të Ri Evropian:

Rezultatet, përfundimet ose ndikimi i demonstruar i propozimit në lidhje me objektivat e tij dhe me atë që pritet në kontekstin e kategorisë përkatëse. Këtu përfshihen edhe përfitimet nga projekti për përfituesit e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë. Konceptet duhet të ofrojnë zgjidhje lokale për sfidat globale. (**10 / 100 pikë**)

Për kapitullin B: Yjet e Bauhaus-it të Ri Evropian:

Rëndësia, cilësia dhe besueshmëria e planit të **zhvillimit të konceptit**, duke i kushtuar vëmendje të veçantë hapave të parashikuar në vitin pas aplikimit. Ky plan duhet të përfshijë shtrirjen e rezultateve dhe përfitimeve të parashikuara nga zbatimi i konceptit për përfituesit e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë. Rezultatet dhe përfitimet duhet të specifikohen në lidhje me objektivat e konceptit dhe me atë që pritet në kontekstin e kategorisë përkatëse. Konceptet duhet të ofrojnë zgjidhje lokale për sfidat globale. **(10 / 100 pikë)**

8.3. Kriteret plotësuese për dhënien e çmimit:

Duke pasur parasysh renditjen e aplikimeve në bazë të kriterëve të listuara më sipër, në përzgjedhjen përfundimtare, juria (që rekomandon fituesit e çmimit mes finalistëve) do të marrë parasysh edhe këto kriterë të tjera:

- (i) diversitetin gjeografik, duke u siguruar që një e katërta e projekteve dhe koncepteve të jenë të vendosura në rajonet e BE-së që përballen me sfida më intensive socio-ekonomike dhe në vende të sfiduara më shumë nga nevoja për të evoluar drejt një ekonomie neutrale ndaj karbonit. (Shiko hartat e rajoneve të pranueshme të konsideruara në Shtojcën 1, së bashku me një listë të këtyre rajoneve në Shtojcën 2).
- (ii) ekuilibrin midis aplikimeve që i referohen transformimit fizik të mjedisit të ndërtuar ('investimet e mëdha') dhe llojeve të tjera të transformimeve ('investimet e vogla')
- (iii) shumëllojshmërinë e konteksteve (rurale/urbane, shkallë e vogël/shkallë më e madhe, etj.).

Për sa i përket diversitetit gjeografik, juria do të kujdeset që asnjë shtet anëtar pjesëmarrës i BE-së, Ballkanit Perëndimor ose Ukraina të mos përfaqësohet më shumë se dy herë në çmimet e dhëna në të gjitha kategoritë dhe fushat, duke përfshirë rezultatin nga votimi publik dhe çmimin "Vlerësim i veçantë për përpjekjet për rindërtim dhe rimëkëmbje të Ukrainës".

Ky rregull vlen edhe për aplikimet me një shtrirje gjeografike ndërkombëtare të përcaktuar/në Kriteret e Pranimit (pikat 18 dhe 22). Kjo do të thotë se i njëjti shtet anëtar i BE-së, partner i Ballkanit Perëndimor ose Ukraina nuk mund të përfaqësohet më shumë se katër herë në total midis të gjithë fituesve (maksimumi dy herë për aplikimet me shtrirje gjeografike kombëtare dhe maksimumi dy herë për aplikimet me shtrirje gjeografike ndërkombëtare).

9. Procesi i përzgjedhjes

Procesi i përzgjedhjes së fituesve organizohet dhe shqyrtohet nga një Komision Vlerësimi i përbërë nga përfaqësues të Komisionit Evropian. Komisioni do të sigurojë respektimin e rregullave të zbatueshme, duke përfshirë edhe konfliktin e interesit. Komisioni nuk i vlerëson vetë aplikimet.

Procesi i përzgjedhjes do të realizohet në disa hapa.

1. Kontrolli i përshtatshmërisë (i planifikuar për nëntor-dhjetor 2023)

Komisioni i Vlerësimit do të shqyrtojë të gjitha aplikimet për të vlerësuar përshtatshmërinë e tyre sipas kriterëve të renditura më poshtë.

2. Vlerësimi i cilësisë (i planifikuar për janar-shkurt 2024)

Ekspertët e jashtëm do të përzgjidhen nga shërbimet e Komisionit Evropian për të kryer vlerësimin e aplikimeve. Komisioni Evropian do të publikojë një 'Thirrje për Shprehje Interesi' duke kërkuar ekspertë që demonstrojnë ekspertizë përkatëse në lidhje me Bauhaus-in e Ri Evropian (diversitet i balancuar i ekspertizës rreth qëndrueshmërisë, gjithëpërfshirjes dhe estetikës). Gjithashtu, do të tregohet kujdes për të pasur edhe një ekuilibër gjinor dhe gjeografik. Ekspertët nuk duhet të kenë asnjë lloj pjesëmarrjeje në aplikimet e paraqitura dhe asnjë konflikt interesi me aplikimet e paraqitura për konkursin e Çmimit të Bauhaus-it të Ri Evropian.

Ekspertët e përzgjedhur do të vlerësojnë aplikimet dhe do t'u caktojnë pikët bazuar në kriteret e çmimit të përmendura në pikën 8. Çdo aplikim i pranueshëm do të vlerësohet nga dy ekspertë të ndryshëm.

Lista e finalistëve do të përcaktohet duke përzgjedhur tre aplikimet me pikët më të larta në secilën kategori dhe kapitull për një numër minimal prej 24 finalistësh. Lista e finalistëve do të krijohet më pas sipas rregullave të mëposhtme:

- Së pari, nëse një shtet i caktuar anëtar i BE-së, partner i Ballkanit Perëndimor ose Ukraina nuk përfaqësohet në 24 aplikimet më të mira, projekti i pranueshëm me vlerësimin më të mirë nga ky vend do t'i shtohet listës së finalistëve.
- Së dyti, nëse një e katërta e finalistëve nuk janë nga rajone në BE që përballen me sfida më intensive socio-ekonomike dhe nga vende të sfiduara më shumë nga nevoja për të evoluar drejt një ekonomie neutrale ndaj karbonit, aplikimet e pranueshme me vlerësimin më të lartë nga këto rajone do të përfshihen në listën e finalistëve (shih hartën e rajoneve të pranueshme të konsideruara në Shtojcën 1, së bashku me listën e këtyre rajoneve në Shtojcën 2).
- Së treti, nëse lista e finalistëve nuk përfshin një minimum prej tre aplikimesh të pranueshme për çmimin "Vlerësim i veçantë për përpjekjet për rindërtim dhe rimëkëmbje të Ukrainës", tre aplikimet e pranueshme me pikët më të larta për këtë çmim specifik do të përfshihen dhe do të shtohen në listë.

Këto rregulla zbatohen me kusht që aplikimi(et) me vlerësimin më të lartë të kenë plotësuar të gjitha kriteret e pranueshmërisë dhe të kenë reflektuar cilësinë minimale, që do të thotë të paktën 50% të pikëve në secilën kategori çmimesh.

Në rast se numri i finalistëve i kalon 60 aplikime, Komisioni i Vlerësimit mund të vendosë të kryejë një rishikim të plotë të listës së finalistëve, me synimin për ta reduktuar atë në një numër të përshtatshëm, në përputhje të plotë me kriteret e mëposhtme:

- (i) rezultatin mesatar që rrjedh nga pikët e atribuuara nga dy ekspertët përgjegjës për vlerësimin e cilësisë së aplikacionit të caktuar.
- (ii) diversitetin gjeografik, duke u siguruar që një e katërta e projekteve dhe koncepteve të jenë të vendosura në rajone të BE-së që përballen me sfida

më intensive socio-ekonomike dhe në vende të sfiduara më shumë nga nevoja për të evoluar drejt një ekonomie neutrale ndaj karbonit, (shih hartat e rajoneve të pranueshme të konsideruara në Shtojcën 1, së bashku me listën e këtyre rajoneve në Shtojcën 2).

- (iii) ekuilibrin midis aplikimeve që i referohen transformimit fizik të mjedisit të ndërtuar ('investimet e mëdha') dhe llojeve të tjera të transformimeve ('investimet e vogla').
- (iv) shumëllojshmërinë e konteksteve (rurale/urbane, shkallë e vogël/shkallë më e madhe, etj.).

3. Votimi i publikut (i planifikuar për mars 2024)

Aplikimet e finalistëve do të publikohen në faqen e internetit për t'u votuar nga publiku për të përcaktuar fituesin e votës së publikut për secilin kapitull (gjithsej 2 fitues). Votimi publik do të jetë i hapur për të gjithë individët dhe subjektet që mund të dëshirojnë të votojnë për sa kohë që kanë një adresë të vlefshme emaili. Votimi do të bëhet përmes një sistemi të sigurt online. Çdo votues do të ftohet të votojë për dy aplikime për secilin kapitull (secili votues mund të përzgjedhë deri në 4 aplikime). Do të vlerësohet aplikimi më i mirë i votuar për çdo kapitull.

4. Vlerësimi i jurisë (i planifikuar për shkurt-mars 2024)

Aplikimet e finalistëve do të vlerësohen nga një juri përfundimtare ekspertësh e përbërë nga nëntë anëtarë. Ekspertët e jurisë përfundimtare do të zgjidhen për të siguruar një larmi të balancuar ekspertize të tre dimensioneve (qëndrueshmërisë, përfshirjes dhe estetikës) të nismës Bauhaus-i i Ri Evropian. Kujdes do të tregohet për të pasur edhe një ekuilibër gjinor dhe gjeografik. Anëtarët do të vërtetojnë gjithashtu se nuk kanë asnjë konflikt të mundshëm interesi në lidhje me ndonjë nga aplikimet finaliste.

Juria përfundimtare do të bëjë një propozim për 18 projektet dhe konceptet fituese në secilën kategori dhe kapitull, duke përfshirë kampionët dhe nënkampionët, si dhe kampionin dhe nënkampionin e çmimit 'Vlerësim i veçantë për përpjekjet për rindërtim dhe rimëkëmbje të Ukrainës', duke marrë parasysh cilësinë e aplikimeve, si dhe të gjitha kriteret plotësuese të specifikuar në kriteret e dhënies.

Juria përfundimtare do të funksionojë në bazë të konsensusit. Në rast divergjencash të vazhdueshme mes pikëpamjeve të anëtarëve të jurisë, vendimet mund të merren sipas rregullit të votimit me shumicë të thjeshtë.

5. Përcaktimi i rezultateve (i planifikuar për mars 2024)

Komisioni i Vlerësimit fillimisht do të kontrollojë rregullsinë e të gjithë procesit, do të shqyrtojë rezultatet e votimit publik dhe propozimin e jurisë përfundimtare dhe do të përcaktojë listën e fituesve të përzgjedhur - 20 fitues gjithsej, përfshirë kampionët dhe nënkampionët.

Secili fitues mund të marrë çmim vetëm një herë, d.m.th. ose përmes votimit të publikut ose rekomandimit të jurisë. Në rast se ndonjë nga dy fituesit e votimit publik bën pjesë në listën përfundimtare të 18 aplikimeve më të vlerësuara, të propozuara nga juria përfundimtare, ata do të zëvendësohen nga aplikimi i dytë më i vlerësuar në të njëjtin

kapitull dhe kategori. E njëjta gjë vlen edhe për çmimin 'Vlerësim i veçantë për përpjekjet për rindërtim dhe rimëkëmbje të Ukrainës'.

Komisioni Evropian do t'u japë çmimet fituesve të përzgjedhur bazuar në rekomandimet e Komisionit të Vlerësimit.

10. Anulimi i çmimit

Komisioni Evropian mund ta anulojë konkursin ose të vendosë të mos akordojë çmimin në ndonjë prej kategorive ose në të gjitha kategoritë, pa qenë i detyruar që të kompensojë pjesëmarrësit, nëse: (a) nuk janë dorëzuar aplikime; (b) komisioni i vlerësimit nuk mund të gjejë një fitues në secilën kategori apo kapitull; c) fituesit nuk janë të përshtatshëm ose duhet të përjashtohen.

11. Tërheqja e çmimit

Komisioni Evropian mund ta tërheqë çmimin pas dhënies së tij dhe të tërheqë të gjitha pagesat e bëra, nëse zbulon se: (a) është përdorur informacion i rremë, mashtrim ose korrupsion për marrjen e tij; (b) fituesi nuk ishte i përshtatshëm ose duhej të ishte përjashtuar; (c) fituesi ka shkelur detyrimet e tij sipas rregullave të mësipërme të këtij konkursi.

ANNEXES

Annex 1: Maps of eligible regions and territories in the EU considered for one fourth of the prizes

Annex 2: List of eligible regions and territories in the EU considered for one fourth of the prizes

Annex 3: Eligibility Criteria at a glance

All Annexes are available on the Prizes 2024 platform, they are all in English.

Please find them just above this Guide to Applicants under 'Guide to Applicants' on the platform.